



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:228789  
Datë: 21.05.2024  
Numri i dokumentit: 05716072

Ac.nr.8621/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Nora Bllaca-Dula, kryetare e kolegjit, Malsor Kryeziu dhe Faton Ademi, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit E.H nga P....., i cili sipas autorizimit përfaqësohet nga B.J, avokat nga Prishtina, kundër të paditurit “D M” Sh.P.K, me seli në M....., Rruga “M.....”, p.n, me pronar A.K, nga Komuna e Mitrovicës, i cili sipas autorizimit përfaqësohet nga M.P, avokat nga Prishtina, për shkak të pengim posedimit, duke vendosur sipas ankesës së paditësit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2546/2018 i datës 02.11.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 21.05.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e paditësit E.H nga P....., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2546/2018 i datës 02.11.2023, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin C.nr.2546/2018 i datës 02.11.2023, ka vendosur si në vijim: “ *I. REFUZOHET e pabazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit E.H nga P....., me të cilën ka kërkuar që të URDHËROHET i padituri “D M” Sh.P.K, me seli në M....., Rruga “M.....”, p.n, me pronar A.K, që të i mënjanoj të gjitha format e shfaqura të deritanishme të*

*pengim posedimit ndaj palës paditëse dhe shqetësimet eventuale përcjellëse, duke i'a njohur paditësit të drejtën e shfrytëzimit dhe të posedimit të lirshëm të paluajtshmërive, me numër të ngastrës kadastrale ....., me sipërfaqe të përgjithshme prej 4269 m<sup>2</sup>, ngastrës kadastrale me numër ....., me sipërfaqe të përgjithshme prej 2095m<sup>2</sup>, ngastrës kadastrale me numër ....., në sipërfaqe të përgjithshme prej 12090 m<sup>2</sup>, ngastrës kadastrale me numër ....., me sipërfaqe të përgjithshme prej 2844m<sup>2</sup>, ngastrës kadastrale me numër ....., në sipërfaqe të përgjithshme prej 1837 m<sup>2</sup>, ngastrës kadastrale me numër ....., në sipërfaqe të përgjithshme prej 800 m<sup>2</sup>, ngastrës kadastrale me numër ....., në sipërfaqe të përgjithshme prej 1150 m<sup>2</sup>, dhe ngastrës kadastrale me numër ....., në sipërfaqe të përgjithshme prej 1389 m<sup>2</sup>, Zyra Kadastrale në P.....*

*II. DETYROHET paditësi E.H nga P....., që të paditurës "D M" Sh.P.K, me seli në M....., Rruga "M.....", p.n, me pronar A.K, t'ia kompensoj shumën prej 810.00 €, në emër të shpenzimeve procedurale".*

Kundër këtij aktvendimi paditësi, përmes të autorizuarit të tij, në afat ligjor ka paraqitur ankesë dhe atë për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabueshëm të së drejtës materiale, me propozim gjykatës së shkallës së dytë që aktvendimin e atakuar ta ndryshojë, ashtu që të aprovohet si e bazuar në ligj ankesa e palës paditëse, të aprovohet në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditësit ose që aktvendimi i atakuar të priset dhe çështja të kthehet në rigjykim të sërishëm.

Përgjigje në ankesë ka parashtruar i padituri, përmes të autorizuarit të tij, duke e kundërshtuar në tërësi si të pabazuar ankesën e paditësit, me propozim që aktvendimin e atakuar të vërtetojë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

*-Ankesa e paditësit është e pathemeltë.*

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi përmes të autorizuarit të tij, pranë gjykatës së shkallës së parë, me datën 24.08.2018, ka parashtruar padi kundër të paditurit, ndërsa në shqyrtimin kryesorë të datës 05.12.2018 ka bërë rregullimin e padisë në kuptimin subjektiv ku si palë e paditur të jetë DM sh.p.k me pronar A.K, për shkak të objektit të kontestit pengim posedimi, duke kërkuar nga gjykata që të urdhërohet i padituri si pronar dhe drejtor i Shoqërisë "DM" sh.p.k me seli në M....., që t'i mënjanojë të gjitha format e shfaqura të deritanishme të pengimposedimit ndaj palës paditëse dhe shqetësimet eventuale përcjellëse, duke ia dorëzuar edhe pengimin faktik të njëjtit në afatin prej 15 ditësh nga dita e vendosjes në gjykatën e shkallës së parë, më decidivsiht si në petitumin e saj.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit dhe rregullimit të kërkesëpadisë, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave dhe të gjitha shkresave të lëndës ka nxjerrë aktvendimin C.nr.2546/2018 i datës 02.11.2023, me të cilin e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivsiht si në dispozitiv të aktvendimit të njëjtë.

Në arsyetim të aktvendimit, gjykata e shkallës së parë nga provat e administruara ka vërtetuar se në rastin konkret, nuk dëshmojnë se i padituri ka kryer aktin e pengim posedimit. Kështu që

paditësi me padi për pengim posedimi në rastin konkret nuk mund të gëzojnë mbrojtje juridike për shkak se veprimet e të paditurit nuk mund të cilësohen si veprime anti juridike, ndërsa veprimi anti juridik është si kusht ligjor që paditësi të gëzon mbrojtje juridike me padi për pengim posedimi edhe për këto arsye është refuzuar kërkesëpadia e paditësit. Kjo për faktin se nga provat e ofruara nga palët në procedurë, gjykatës së shkallës së parë i ka rezultuar se i padituri nuk ka kryer ndonjë veprim material-juridik, me të cilin ka shkaktuar pengimin e posedimit siç pretendohet nga ana e paditësit, për aq kohë sa veprimet e të paditurit nuk paraqesin aktin e pengim posedimit, prandaj as i padituri nuk mund të mbahet përgjegjës për veprimet e kryera, për të cilat veprime nuk ka dëshmi se të njëjtat paraqesin aktin e pengim posedimit. Duke pasur parasysh se procedura për pengim posedim ka për qëllim vendosjen e gjendjes së fundit faktike të posedimit, me padinë e paditësit nuk mund të kërkohet një gjë e tillë, sepse paditësi asnjëherë nuk ka pasur as nuk ka krijuar pushtet faktik-posedim mbi palujtshmëritë lëndore, e kjo është konstatuar edhe nga ekspertiza gjeodezike e punuar nga eksperti Q.H dhe sqarimet plotësuese të dhëna në seancën e datës 25.10.2023, nga eksperti i njëjtë, ku gjykata ka konstatuar faktin se ngastrat kadastrale të cilat paditësi pretendon që i ka në shfrytëzim faktik, konkretisht ngastra kadastrale me numër ....., me sipërfaqe të përgjithshme prej 4269 m<sup>2</sup>, e cila gjendet në vendin e quajtur “V.....”, dhe ngastra kadastrale me numër ....., me sipërfaqe të përgjithshme prej 2095 m<sup>2</sup>, e cila gjendet në vendin e quajtur “V.....”, evidentohen në emër të KBI “Kosova – Export”, rrjedhimisht kanë statusin e pronës shoqërore e cila është vërtetuar edhe certifikatat pronësore, ndërsa me daljen në vendshiqim të gjykatës me datë 02.09.2022, bashkë me palët ndërgjyqëse, sipas gjendjes në terren është konstatuar se ngastrat lëndore janë të parrethuara, dhe të papunuara, si dhe të njëjtat nuk kanë asnjë material të vendosur mbi to, andaj edhe gjykata nga vlerësimi i gjithmbarshëm i provave shkresore në këtë procedurë, dhe konstatimit të gjendjes faktike, ka ardhur në përfundim se padia e paditësit është e pathemeltë, ndërsa, njëri prej elementeve kryesore të pengim posedimit është edhe kundërligjshmëria, apo pengimi i posedimit në mënyrë të kundërligjshme nga ana e të paditurit, gjë e cila nuk mund të konstatohet në rastin konkret.

Gjykata e shkallës së parë në këtë procedurë është kufizuar vetëm në konstatimin dhe provimin e fakteve të gjendjes së fundit të posedimit dhe të pengimit të këtij pushteti në mënyrë të kundërligjshme dhe të padrejtë, pa u lëshuar fare në çështjet që kanë të bëjnë me të drejtën e posedimit, bazën juridike të posedimit, ndërgjegjshmërinë apo pandërgjegjshmërinë e posedimit apo ndonjë të drejtë tjetër sendore, e të cilat eventualisht do të ishin objekt kontesti në ndonjë procedurë tjetër, por që nuk mund të gëzojë mbrojtje ligjore sipas dispozitave të pengim posedimit. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se kërkesa e paditësit për pengim posedimi në këtë rast nuk është në harmoni me dispozitën ligjore të nenin 114 të LPTDS-së, ngase paditësi nuk e ka provuar faktin e gjendjes së fundit faktike të posedimit dhe të pengimit të bërë, se kur ka ndodhur pengim posedimi, data, koha e kryerjes së aktit të pengim posedimit.

Gjykata e shkallës së parë, aktvendimin e atakuar e ka marrë në pajtim me dispozitat e nenit 103, 104 dhe neni 113 paragrafi 1 dhe 2 dhe neni 114 të LPDTS, e lidhur me nenin 480 dhe 322.2 të LPK-së, ndërsa për shpenzimet e procedurës në pajtim me nenet 452.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e Kosovës, nisur nga kjo gjendje e çështjes, vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi

i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së. Aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë as në shkeljet tjera për të cilat pretendon pala ankuese në ankesë dhe gjykata e shkallës së parë në bazë të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, drejtë ka zbatuar të drejtën materiale, përkatësisht nenin 103, 113 të LPDTS.

Gjykata e Apelit nuk i pranon pretendimet ankimore të paditësit se aktvendimi i ankimuar është marrë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, edhe pse pala ankuese nuk thirret konkretisht në asnjë dispozitë procedurale. Gjykata e Apelit vlerëson se dispozitivi i aktvendimit të ankimuar është i qartë dhe në pajtim me arsyetimin, gjykata ka paraqitur arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare që kanë të bëjnë me posedimin dhe pretendimet e paditësit për aktin e pengimit të posedimit. Në kontestet e pengimit të posedimit gjykata është e obliguar të provoj faktet lidhur me gjendjen e fundit të posedimit dhe pengimit të bërë, ndërsa në këtë rast nga provat e administruara është vërtetuar se në rastin konkret nuk është vërtetuar akti i pengim posedimit, pasi që në rastin konkret paditësi nuk arriti të provojë se i padituri e ka penguar paditësin me ndonjë veprim.

Sipas dispozitës së nenit 103 të LPDTS-së, parashihet se *“personi që e ushtron pushtetin faktik është posedues i drejtpërdrejtë”*, ndërsa sipas nenit 104 të LPDTS-së, parashihet se *“Posedimi në një send fitohet me krijimin e pushtetit faktik mbi sendin. Marrëveshja e poseduesit të mëparshëm dhe e fituesit të posedimit është e mjaftueshme për fitimin e posedimit, nëse fituesi është në gjendje që të ushtrojë pushtetin mbi sendin në momentin e marrëveshjes”*, e sipas nenit 113 paragrafi 1 të të njëjtit ligj parashihet se *“nëse poseduesi privohet nga posedimi në mënyrë të kundërligjshme, poseduesi mund të kërkojë rivendosjen e posedimit prej personit ndërhyrës...”*, ndërsa paragrafi 2 parasheh se *“nëse poseduesi pengohet në posedim në mënyrë të kundërligjshme, atëherë poseduesi mund të kërkojë nga penguesi mënjanimin e pengesave. Nëse priten pengime në të ardhmen, poseduesi mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore”*, ndërsa neni 322, par. 2 të LPK-së: *“Pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provojë faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër”*. e që në rastin konkret nuk është vërtetuar me asnjë provë të vetme akti i pengim posedimit të jetë kryer nga i padituri, nuk është vërtetuar se paditësi ka pasur në posedim paluajtshmërinë lëndore për të cilën është iniciuar kjo procedurë kontestimore, përkatësisht për të cilën është paraqitur padia për pengim posedimi dhe se i njëjti është penguar nga i padituri në ushtrimin e posedimit. Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë drejtë ka arsyetuar se paditësi me padi për pengim posedimi nuk mund të gëzojë mbrojtje juridike, konform nenit 480 të LPK-së, për shkak se nuk është provuar se i njëjti ndonjëherë ka hyrë në posedim të paluajtshmërisë për të cilën ka paraqitur padinë, e që është kusht themelor për të iniciuar një padi të tillë, pra paditësi asnjëherë nuk ka pasur as nuk ka krijuar pushtet faktik-posedim mbi paluajtshmëritë lëndore, fakt që është konstatuar edhe nga ekspertiza gjeodezike e ekspertit Q.H dhe sqarimet plotësuese të dhëna në seancën e datës 25.10.2023, nga eksperti i njëjtë, ku gjykata e shkallës së parë ka konstatuar faktin se ngastrat kadastrale të cilat paditësi pretendon që i ka në shfrytëzim faktik, evidentohen në emër të KBI “Kosova – Export”, rrjedhimisht kanë statusin e pronës shoqërore, e cila është vërtetuar edhe certifikatat pronësore, ndërsa me daljen në vendshiqim të gjykatës me datë

02.09.2022, bashkë me palët ndërgjyqëse, sipas gjendjes në terren është konstatuar se ngastrat lëndore janë të parrethuara dhe të papunuara, si dhe të njëjtat nuk kanë asnjë material të vendosur mbi to, andaj pretendimet e paditësit në këtë drejtim u refuzuan të pathemelta, sepse gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike, nga e cila ka rezultuar e pathemeltë kërkesëpadia e paditësit.

Në rrethana të tilla rezulton se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe plotësisht ka vërtetuar faktet që kanë të bëjnë me gjendjen e fundit të posedimit dhe pretendimit për aktin e posedimit, ku mbi këtë pazë ka nxjerr përfundimin e drejtë se paditësi me asnjë provë të vetme nuk ka arritur të provojë aktin e pengim posedimit, respektivisht nga të gjitha provat e administruara është vërtetuar se paditësi nuk ka qenë në posedim të fundit të ngastrës kontestuese, andaj edhe nuk ka pasur akt të pengimit të posedimit nga i padituri, prandaj edhe përfundimi i gjykatës është në pajtim me të drejtën materiale.

Bazuar në nenin 480 të LPK-së i cili parasheh që shqyrtimi i çështjes të padisë për shkak të pengimit të posedimit, kufizohet vetëm në konstatimin dhe të provuarit e fakteve të gjendjes së fundit të posedimit dhe të pengimit të bërë. Përrjashtohet mundësia e shqyrtimit lidhur me të drejtën e posedimit, me bazën juridike, ndërgjeshmërinë ose pandërgjegjshmërinë e posedimit, andaj edhe kjo gjykatë e vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar me refuzimin e kërkesëpadisë të paditësit si të pathemeltë.

Gjykata e Apelit gjeti se në pajtim me nenin 452.1 të LPK-së është vendosur për shpenzimet e procedurës kontestimore.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i vlerësoi edhe pretendimet tjera ankimore të paditësit dhe gjeti se janë të pathemelta dhe nuk ndikojnë në marrjen e vendimit ndryshe nga ajo të cilin e ka marrë gjykata e shkallës së parë, andaj në kuptim të nenit 209 par.1 pika b) të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.8621/2023, me datë 21.05.2024

Kryetare e kolegjit  
Nora Bllaca-Dula, d.v.